



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 dhjetor 2011
Nr. ref.:AGJ165 /11

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO 119/10

Parashtruesi

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon anulimin e nenit 14 paragrafit 1.6, si dhe të neneve 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, dhe neneve 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010.

Baza juridike

4. Neni 113.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenet 20 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 nëntor 2010, Avokati i Popullit e parashtrroi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 nëntor 2010, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendim Nr. GJR. 119/10, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendim Nr. KSH. 119/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues në lidhje me Kërkesën në një seancë të mbyllur dhe mori vendim për aplikimin e masës së përkohshme për një periudhë kohore jo më të gjatë se tre muaj nga dita e marrjes së vendimit, duke pezulluar menjëherë zbatimin e nenit 14 paragrafit 1.6, dhe të neneve 22, 24, 25 dhe 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010, në kohëzgjatje të njëjtë.
8. Gjykata e vazhdoi aplikimin e masës së përkohshme në disa raste pasuese dhe së fundi, me Urdhrin e 20 tetorit 2011, e vazhdoi aplikimin deri më 31 dhjetor 2011, dhe Gjykata mbetet e përkushtuar në këtë çështje.
9. Më 21 dhjetor 2010, Gjykata e njoftoi Kryetarin e Kuvendit të Kosovës lidhur me këtë Kërkesë dhe pyeti nëse Kuvendi kishte ndonjë përgjigjeje lidhur me Kërkesën e parashtruar në Gjykatë.
10. Më 24 janar 2011, z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dërgoi një shkresë zyrtare me anë të së cilës e njoftoi Gjykatën se Kuvendi është i njoftuar me masën e përkohshme të aplikuar nga Gjykata lidhur me pezullimin e zbatimit të neneve të caktuara të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit derisa masa e përkohshme të jetë në fuqi, dhe gjithashtu theksoi se duke marrë parasysh faktin se Kuvendi i Kosovës ishte i shpërndarë që nga 2 nëntori 2010, ai nuk mund të jepte përgjigje adekuate deri në konstituimin e legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës.
11. Më 16 maj 2011, z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit, ia dorëzoi Sekretares së Përgjithshme të Gjykatës një përgjigje të përgatitur nga Komisioni i Kuvendit për

Legjislacion, të 11 majit 2011. Ajo përgjigje konkludoi që legjislacioni që është objekt i kësaj Kërkesë ishte në pajtim me Kushtetutën sepse ishte miratuar në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit.

12. Më 5 korrik 2011 dhe më 22 nëntor 2011, Gjykata shqyrtoi Kërkesën dhe përgjigjen, dhe vendosi për pranueshmëri dhe merita të Kërkesës.

Faktet

13. Më 4 qershor 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) miratoi Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit me 74 (shtatëdhjetë e katër) vota "për", 2 (dy) vota "kundër" dhe 2 (dy) "abstenime".
14. Ndërmjet 7 tetorit 2008 dhe 16 marsit 2010, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi u takua së paku shtatë (7) herë për të diskutuar për këtë legjislacion të propozuar. Më 21 tetor 2008, Komisioni i pranoi komentet e OSBE-së lidhur me këtë legjislacion. OSBE-ja posaçërisht rekomandoi:

"Dispozita për pension suplementar duhet të fshihet pasi është e tepërt lidhur me rregullat për pensione të rregullta. Dispozita e tillë do të vinte barrë të madhe në buxhetin shtetëror." (Shih, Komentet specifike dhe ndryshimet e propozuara në Projektligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, OSBE).

15. Më 14 dhjetor 2009, një anëtar i Komisionit rekomandoi që vendimi për miratimin e këtij legjislacioni duhet të shtyhet derisa të mos krijohen kushte "më të mira politika dhe ekonomike".
16. Më 13 qershor 2008, Kuvendi e miratoi Ligjin për Fondin Pensional të Kosovës, Nr. 03/L-084.
17. OJQ-të e mëposhtme: Instituti Nacional Demokratik i Kosovës (NDI), Forumi për Iniciativë Qytetare (FIQ), Lëvizja "Fol", Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM), iu drejtuan Presidentit të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2010 me një kërkesë për të mos e shpallur Ligjin e lartpërmendur.
18. Më 25 qershor 2010, z. Bahri Hyseni, kryesues i Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Legjislacion dhe Gjyqësi, kërkoi nga Sekretariati e Kuvendit ta korigjonte një gabim teknik që ishte bërë në Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, përkatësisht në nenin 22 të Ligjit, se mosha e pensionimit do të duhej të ishte 55 vjet, e jo siç ishte miratuar në seancën plenare të 4 qershorit 2010 që mosha e pensionimit duhet të jetë 50 vjet.
19. Më 25 qershor 2010, Kuvendi e miratoi kërkesën e z. Bahri Hyseni për korigjimin e gabimit teknik, të bërë në seancën e 4 qershorit 2010. Kërkesa e z. Bahri Hyseni u miratua me 73 (shtatëdhjetë e tri) vota "për" dhe 2 (dy) vota "kundër".
20. Më 5 korrik 2010, Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit u dekretua nga Presidenti i Republikës së Kosovës me Dekretin DL-029-2010.
21. Më 19 korrik 2010, Institucioni i Avokatit të Popullit mori një parashtresë nga një numër e OJQ-ve: Instituti Demokratik Kombëtar i Kosovës (NDI), Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Iniciativa për Progres (INPO), Instituti Ballkanik për Politika (IPOL), Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), Lëvizja "FOL", Ndërtimi i Komunitetit Mitrovicë (CBM), Qendra për

Politika dhe Avokim (QPA) dhe Syri Vision, të cilat iu drejtuan Institucionit të Avokatit të Popullit me një kërkesë të përbashkët që Gjykata Kushtetuese e Republikës e Kosovës, në bazë të detyrave dhe përgjegjësi që i janë dhënë me ligj, ta vlerësojë kushtetutshmërinë e nenit 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

22. OJQ-të e lartpërmendura konsiderojnë se ky nen përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe kërkojnë të ndalohej zbatimi i ligjit, ashtu siç është paraparë nga 1 janari 2011, deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim meritor për këtë çështje.
23. Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 20 korrik 2010.
24. Më 21 korrik 2010, kërkesës së OJQ-ve iu bashkua edhe Sindikata e Pensionistëve të Kosovës.
25. Më 16 maj 2011, z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit, ia dorëzoi Sekretares së Përgjithshme të Gjykatës një përgjigje të përgatitur nga Komisioni i Kuvendit për Legjislacion, të 11 majit 2011. Ajo përgjigje konkludoi që legjislacioni që është objekt i kësaj Kërkesë ishte në pajtim me Kushtetutën sepse ishte miratuar në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit.
26. Më 26 korrik 2011, Banka Qendrore e Kosovës, në letrën e nënshkruar nga z. Gani Gërguri, Guvernator i Bankës Qendrore, e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se nuk kishte pasur korrespondencë ndërmjet Bankës Qendrore dhe Kuvendit të Kosovës lidhur me ndikimin fiskal dhe ekonomik për miratimin e këtij Ligji, Nr. 03/L-111.
27. Më 27 korrik 2011, Ministria e Financave, në letrën e nënshkruar nga ministri, z. Bedri Hamza, e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se Ministria e Financave kishte marrë një kërkesë me shkrim nga Kuvendi i Kosovës lidhur me shpenzimet apo ndikimin financiar të projektligjit të propozuar. Ministria kishte përgatitur një raport si përgjigje në këtë kërkesë, por raporti kurrë nuk i ishte dërguar Kuvendit sepse nevojiteshin konsultime të mëtejme para se ky ligj të mund të miratohej. Megjithatë, më 4 qershor 2010, Kuvendi i Kosovës e miratoi këtë projektligj pa vlerësimin e ministrit të Financave për ndikimin ekonomik dhe fiskal të këtij ligji, Nr. 03/L-111.
28. Këto dy përgjigje iu përcollën Kuvendit të Republikës së Kosovës në fund të gushtit 2011, vetëm për informim. Nuk u kërkuar asnjë përgjigje. Nuk është marrë asnjë përgjigje apo koment.
29. Më 4 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese mori materiale me shkrim, të cilësuar si "punë përgatitore", që kanë të bëjnë me Ligjin për pensione për anëtarë të ndryshëm të Parlamentit, 02/L-144, që u miratua nga Kuvendi në vitin 2007, por që nuk ishte aprovuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, dhe, si rrjedhojë, kurrë nuk ishte miratuar. Asgjë në ato materiale lidhur me ligjin në fjalë, Nr. 03/L-111, të kontestuar nga Avokati i Popullit në Kërkesën e tij.

Pretendimet e parashtruesit

30. Avokati i Popullit pretendon, ndër të tjera, se Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit përmban dispozita që "u mundësojnë deputetëve të Kuvendit të Kosovës të realizojnë pensione që janë më të favorshme se çdo përfitim tjetër pensional për qytetarët e tjerë, dhe se ato dispozita nuk janë në përputhje me parimet kushtetuese të barazisë, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale".

31. Avokati i Popullit gjithashtu "vëren se pensionet suplementare të parapara me nenin 22 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit janë qartazi joproporcionale me pensionet mesatare në vend, dhe si të tilla nuk janë në harmoni me vlerat e proklamuar në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rendi kushtetues i të cilës bazohet në parimet e demokracisë, barazisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale".
32. Për më tepër, neni 38 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit ua ofron deputetëve mundësinë që të kthehen në vendet e tyre përkatëse të punës, nëse ai/ajo ka qenë i/e punësuar në sektorin publik apo në ndonjë institucion të financuar nga fondet publike para fillimit të mandatit. Kjo u jep atyre siguri sa i përket punësimit; ata nuk rrezikojnë të mbesin të papunë nëse kanë qenë pjesë e sektorit publik para fillimit të mandatit të deputetit. Ata, gjithashtu mund të gjejnë ndonjë vend tjetër të punës kur dihet se mosha e përgjithshme e pensionimit në Kosovë është 65 vjet.
33. Së fundi, sipas Avokatit të Popullit, "statusi i privilegjuar për deputetët e Kuvendit të Kosovës në rendin ekzistues juridik të Republikës së Kosovës nuk paraqet arsyetim të mjaftueshëm për nivelin aq të lartë të devijimit nga parimet e përgjithshme në fushën e pensioneve".

Përgjigja e Kuvendit

34. Një përfaqësues i Kuvendit u përgjigj që legjislacioni, që është objekt i kësaj Kërkesë, është në pajtim me Kushtetutën sepse ishte miratuar në përputhje me Rregulloren e punës së Kuvendit.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Para përcaktimit të kriterëve formale për pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata duhet të japë përgjigje në dy çështje themelore:
 - a. Nëse Avokati i Popullit është palë e autorizuar për të ngritur çështje kushtetuese; dhe
 - b. Nëse çështja e ngritur në Gjykatë është çështje kushtetuese.
36. Për të dhënë përgjigjeje të duhur në të dy çështjet e lartcekura, Gjykata i referohet nenit 113.2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"...

Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

[...]

c. Çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekretëve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

d. Përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.

..."

dhe nenit 135.4 të Kushtetues, i cili gjithashtu përcakton:

"Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

37. Bazuar në përkufizimet e mësipërme kushtetuese, Avokati i Popullit ka kompetencë të parashtrorë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, dhe kërkesa e Avokatit të Popullit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së përputhshmërisë së nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010, përmbush kriterin juridik të nenit 113.2 të Kushtetutës për “përputhshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën”.
38. Përveç kësaj, Kërkesa u parashtrua në Gjykatën Kushtetuese para kalimit të afatit gjashtë mujor nga dita në të cilën Ligji duhej të hynte në fuqi. Prandaj, kriteri kohor, sipas nenit 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është përmbushur.
39. Kjo është çështje kushtetuese dhe është e përshtatshme për vlerësim të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese.

Ligji në fuqi

40. Për të dhënë përgjigje të plotë dhe të bazuar në Kushtetutë për çështjen që i është parashtruar për shqyrtim, Gjykata Kushtetuese do të marrë parasysh legjislacionin në fuqi lidhur me pensionet në Kosovë, dhe ai është:

Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111

41. Neni 14.1 (6) i Ligjit përcakton që:

“ ...

Përfitimet financiare dhe materiale të deputetit

Deputeti gjatë ushtrimit të mandatit të tij ka të drejtë kompensimi për:

e. pagë bazë;

f. pagë kalimtare pas përfundimit të mandatit;

g. kompensim për pjesëmarrje në seanca dhe në takime të komisioneve;

h. kompensim për funksionet parlamentare;

i. kompensim të shpenzimeve mujore;

j. pensionet suplementare; dhe

k. të drejtat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

...”

42. Neni 22 i këtij Ligji parasheh:

“ ...

Pensioni suplementar

1. Deputeti, pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë për pension suplementar, nëse detyrën e deputetit e ka ushtruar së paku një mandat dhe e ka mbushur moshën pesëdhjetepesë (55) vjeç.

2. Deputeti që i plotëson kushtet e caktuara me paragrafin 1 të këtij neni, e realizon pensionin suplementar në lartësi prej pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës bazë të deputetit. Deputeti që ka shërbyer në dy (2) mandate në kushtet e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, e realizon pensionin suplementar në vlerë prej gjashtëdhjetë për qind (60 %) të pagës bazë, dhe ai që ka shërbyer në tri (3) e më shumë mandate në lartësi prej shtatëdhjetë për qind (70 %) të pagës bazë.
- ...

43. Neni 23 parasheh:

“ ...

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, të përcaktuara me këtë ligj, fillojnë të rrjedhin nga viti 2001, me certifikimin e mandatit të deputetit.

2. Statusi i deputetit të legjislaturës 1990 - 2000 rregullohet me ligj të veçantë.

...”

44. Neni 24 i të njëjtit Ligj parasheh:

“ ...

Pensioni bazë

Si bazë për përcaktimin e pensionit suplementar shërben paga bazë aktuale e deputetit që realizohet në Kuvend.

Shuma e përgjithshme e pensionit suplementar nuk mund të jetë më e madhe se shtatëdhjetë për qind (70 %) e pagës bazë të deputetit.

...”

45. Neni 25 i këtij Ligji parasheh:

“ ...

Pensionimi për shkak të paaftësisë

1. Deputeti, të cilit për shkak të lëndimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij iu ka shkaktuar paaftësia e përgjithshme për punë, ka të drejtë për pension suplementar pa marrë parasysh stazhin pensional, moshën dhe kohën e kryerjes së detyrave të deputetit.

Pensioni nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet në shumën prej shtatëdhjetë për qind (70 %) të pagës bazë.

...”

46. Neni 26 i Ligjit parasheh:

Rrethanat e veçanta

“Kriter për realizimin dhe përcaktimin e lartësisë së pensionit, është stazhi i përgjithshëm pensional i realizuar në vend dhe jashtë vendit.”

47. Neni 27 parasheh:

“ ...

Pensioni familjar

Anëtarëve të familjes së shfrytëzuesit të pensionit suplementar që ka vdekur, pensioni familjar u përcaktohet në shumën prej shtatëdhjetë për qind (70 %) të atij pensioni në ditën e vdekjes.

Procedurat e parapara për realizimin e të drejtave të pensionit të rregullt janë të aplikueshme edhe për realizimin e pensionit suplementar.

Të drejtën për pensionin familjar e kanë bashkëshorti/ja dhe fëmijët deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, përkatësisht deri në moshën njëzetedy (22) vjeçare, nëse vazhdojnë shkollimin e lartë.

“ ...”

Ligji për Fondin Pensional të Kosovës

48. Kur Kuvendi e miratoi Ligjin Nr. 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, ishte ligj në fuqi që nga viti 2008. Neni 3 i atij ligji përcakton që:

“ ...

Në nenin 1 të Rregullores, paragrafi i titulluar "BPK", do të zëvendësohet në tërësi me formulimin në vijim:

"BQK" do të thotë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që është përgjegjëse si agjenci e pavarur sipas nenit 142 të Kushtetutës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, siguruesve të pensioneve, drejtorëve të mjeteve dhe instrumenteve për investime të hapura si dhe mbajtësve sipas këtij Ligji, dhe ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

“ ...”

49. Neni 6 i të njëjtit Ligj përcakton:

“ ...

Neni 2.2 i Rregullores të zëvendësohet në tërësi me nenin 2.2 në vijim:

2.2 Vendosja e politikës ekonomike lidhur me pensionet si pjesë e politikës buxhetore dhe fiskale është përgjegjësi e Qeverisë. Qeveria e realizon këtë politikë përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Guvernatori i BQK-së, dhe anëtarë të tjerë të emëruar nga Kryeministri, do të përbëjnë grupin punues ndërministror për politikën e pensioneve. Grupi punues për politikën e pensioneve, sipas nevojës, propozon rregulla dhe rregullore të nevojshme për zbatimin e politikës pensionale dhe i bën rekomandime Qeverisë lidhur me fondin e kursimeve pensionale, lejimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e pensioneve në Kosovë.

“ ...”

50. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2009 për Rritjen e Pensioneve për Zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/51, neni 2 parasheh:

“Të drejtën për të përfituar në rritje të pensionit bazë prej 45 euro në 80 euro e kanë të gjithë: Shfrytëzuesit aktual të pensioneve bazë të cilët kanë qenë të siguruar dhe kontributpaqes, në bazë të marrëdhënies së punës, [...]”

51. Neni 3 përcakton:

“Kushtet dhe kriteret e përgjithshme për përfitim në rritje të pensionit bazë: Parashtruesi i kërkesës duhet të ketë moshën 65 vjeçare dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional, sipas dispozitave të Sigurimit Pensional dhe Invalidor, prej tyre së paku 7 vjet e 7 muaj stazh pune në Kosovë.”

Substanca e kërkesës

52. Gjatë vlerësimit të kësaj kërkesë, Gjykata duhet të ketë parasysh se në përgjithësi i tërë legjislacioni supozohet të jetë kushtetues, derisa nuk dëshmohet ndryshe. Mandati i Gjykatës është vetëm ta vlerësojë kushtetutshmërinë e një vendimi ose akti legjislativ, e jo ta vlerësojë ligjshmërinë e tij ose nëse ai mbështetet me politikë të mirë publike. *(Shih nenin 112 të Kushtetutës)*

53. Gjatë vlerësimit, nëse një ligj e cenon Kushtetutën, Gjykata duhet t'i merr parasysh këto dispozita të Kushtetutës:

a. Neni 16:

1. *Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.*(Theks i shtuar)

2. *Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.*

3. *Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.*

4. *Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.* (Theks i shtuar)

b. Neni 3:

1. *Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve [...]*

c. Neni 7 parasheh:

Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë [...]

d. Neni 4.2 i Kushtetutës parasheh:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.”

e. Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

“(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;...”

f. Neni 74 i Kushtetutës parasheh:

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Kufizimet në diskrecionin legjislativ

54. Ka kufizime në të drejtën ose autoritetin e Kuvendit për të miratuar legjislacion:

“

(1) *Legjislacioni duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën dhe parimet e Kushtetutës.*

(2) *Legjislacioni që ndikon në individë, korporata apo personal, duhet të ketë synim legjitim dhe duhet të jetë në proporcion me të drejtat e të gjithë qytetarëve të Kosovës.*

(3) *Legjislacioni që u ofron përfitim të drejtpërdrejtë të posaçëm anëtarëve të Parlamentit, duhet të bazohet në arsye që mbështeten me qëllime të qarta dhe legjitime publike.*

”

55. Legjislacioni i kontestuar duhet të analizohet pikërisht mbi këtë bazë. A i ka marrë parasysh Kuvendi këto parime kur e ka miratuar këtë ligj, dhe a ka përcaktuar se cili ishte qëllimi legjitim i këtij ligji? Nuk ka prova në këtë Gjykatë që sugjerojnë se Kuvendi e përdori atë analizë me rastin e miratimit të këtij legjislacioni.

56. Kjo Gjykatë më herët theksoi se Kushtetuta bazohet në doktrinën e ndarjes së pushteteve. Në Aktgjykimin e vet në Rastin Nr. KO 98/11, të 20 shtatorit 2011, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në paragrafin 44, Gjykata tha: *“Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete”.*

57. Neni 4.2 i Kushtetutës në mënyrë eksplicite thotë që Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ. Nuk ka asnjë referencë tjetër në Kushtetutë për ndonjë degë tjetër të Qeverisë e cila e ka atë autoritet ose përgjegjësi. Neni 74 sugjeron në mënyrë të gjerë e të përgjithshme se Kuvendi do ta ushtrojë atë funksion të vetëm në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe të Kushtetutës.

58. Gjatë zbatimit të atij standardi për këtë legjislacion, Kushtetuta kërkon që Kuvendi të pranojë që të gjithë individët janë të barabartë para ligjit (neni 3) dhe që Kushtetuta bazohet në parimin e barazisë (neni 7). Gjatë zbatimit të këtyre parimeve, Kuvendi gjithashtu duhet të pranojë që parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë (neni 24.3). Me fjalë të tjera, polici i fshatit nuk është medoemos e thënë të ketë të njëjtin kompensim si Kryeministri ose mjeku, sepse secili prej tyre mund të ketë detyra, përgjegjësi dhe shkathtësi të ndryshme.

59. Gjatë miratimit të ligjeve, Kuvendi duhet të veprojë në kuadër të parametrave të nenit 24 të Kushtetutës [Barazia para Ligjit], i cili parasheh:

“ ...

Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

...”

Analiza e legjislacionit

60. Edhe pse ligji i kontestuar me këtë Kërkesë përshkruhet si “pension suplementar”, ai ka shumë tipare që më shumë i ngjajnë një dhurate suplementare pas punësimit sesa një pensioni suplementar tradicional për këto arsye:

I. Për dallim nga pensioni i zakonshëm, asnjërit prej përfituesve nuk u kërkohet që të kontribuojnë për të financuar “pensionin”.

II. “Pensionin” duhet të zbatohet retroaktivisht, dhe në të ardhmen, ndaj çdo deputeti që ka shërbyer paraprakisht në Kuvend që nga viti 2001, disa prej të cilëve tashmë janë pensionuar.

III. “Pensionin” mund t’u paguhet edhe përfituesve të cilët, pas përfundimit të mandateve në Kuvend, kthehen të punojnë për qeverinë apo që tani punojnë për qeverinë.

IV. Ky legjislacion është miratuar pa ndonjë koment apo shqyrtim nga ana e zyrtarëve të caktuar qeveritarë, që janë caktuar sipas ligjit në Kosovë për ta shqyrtuar politikën e pensioneve. Ai ligj, Nr. 03/L-084, parashikonte që disa zyrtarë qeveritarë nga ministri të ndryshme dhe Banka Qendrore e Kosovës ishin përgjegjës për të krijuar politika të pensioneve në Kosovë.

V. Ky nuk është “bonus”, sepse, në mënyrë tipike, bonusi është shtytje shtesë e veçantë për një kandidat të mundshëm për ta marrë një post apo shpërblim në përfundim të vitit fiskal për përmbushje të jashtëzakonshme në lidhje me arritjen apo tejkalimin e objektivave të veçanta të përmbushjes.

VI. Kjo nuk është rritje e pagës. Rritjet e pagës zakonisht kanë vetëm zbatim në të ardhmen për ata që mendojnë të bëhen deputetë në të ardhmen apo t’i përtërijnë mandatet e tyre. Ky legjislacion ka zbatim retroaktiv, gjë që e bën atë të ngjajë më tepër si dhuratë sesa përshtatje e pagës. (*Shih nenin 11, Për pagat e nëpunësve civilë, Ligji Nr. 03/L-147, i 13 majit 2010.*)

VII. Kjo nuk është “pagesë për shkurtim nga puna”. Pagesa për shkurtim nga puna zakonisht paguhet për një periudhë të caktuar kohore apo është pagesë e njëhershme që i paguhet një të punësuarit pasi që ai ose ajo e lë punën. Ky legjislacion autorizon pagesën e një shume të pakufizuar për një periudhë kohore të pakufizuar. (*Shih nenin 22.2, Për pagat e nëpunësve civilë, Ligji Nr. 03/L-147, i 13 majit 2010.*)

VIII. Financimi i këtij pensioni bëhet nga buxheti i përgjithshëm i Qeverisë së Kosovës, jo nga një fond i veçantë i Trustit Pensional i autorizuar me ligjin për pensionet në Kosovë apo ndonjë fond privat pensional i autorizuar për t'u paguar pensione vjetore përfituesve gjatë jetës së tyre, siç është e zakonshme me fondet e rregullta pensionale.

IX. Ky legjislacion dallon nga ligji që ka të bëjë me pensionistët e rregullt në Kosovë, të cilët për ta fituar të drejtën e pensionit nga Buxheti i Kosovës duhet së paku të kenë moshën 65 vjeçare (pensioni i pleqërisë), ose së paku të kenë moshën 65 vjeçare dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional (*shih nenin 3.1.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2009 për rritjen e pensioneve për zbatimin e vendimit të Qeverisë Nr. 02/51*).

Analiza e rolit të deputetëve

61. Deputetët në Kuvend kanë detyra dhe obligime që dallojnë nga pjesa e tjetër e shoqërisë. Ata kanë mandat të kufizuar, orar pune të veçantë, mundësinë që të mos rizgjidhen. Ata duhet ta lënë çdo post ekzekutiv në administratën publike apo në ndonjë ndërmarrje publike dhe të mos ushtrojnë asnjë post ekzekutiv siç parashihet me ligj.
62. Prandaj, për t'i joshur kandidatët e kualifikuar për këto pozita, Kuvendit i lejohet t'i kompensojë kandidatët e rinj të mundshëm për pozitën e deputetit në Kuvend në mënyrë të tillë dhe me një shumë monetare që mund të dallojë nga kompensimi i pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë, deri në masën sa të jetë i arsyeshëm në raport me qëllimin legjitim të joshjes së kandidatëve të kualifikuar në këtë pozitë, duke marrë parasysh kërkesat e pozitës dhe pasigurinë që ndërlihet me këtë pozitë. Nuk ka prova që Kuvendi i ka marrë parasysh këta faktorë gjatë miratimit të këtij legjislacioni.
63. Ky legjislacion i pensioneve, po ashtu, është retroaktiv për çdo deputet që ka shërbyer në Kuvend që nga viti 2001, pa marrë parasysh nëse ai ose ajo është ende duke shërbyer. Kur ligje të ndryshme të pensioneve apo të kompensimit bëhen retroaktive për t'i kompensuar ish-deputetët e Kuvendit, duhet të ketë një konkluzion të veçantë nga Kuvendi për mënyrën si ai legjislacion arrin qëllimin e joshjes së kandidatëve të kualifikuar që do të bënin fushatë dhe do të pranonin pozitën e deputetit me gjithë autoritetin, përgjegjësinë dhe sakrificën e veçantë. Nuk duket që Kuvendi ka bërë ndonjë konkluzion të tillë në lidhje me këtë çështje.

Pensionet për deputetë në vende të tjera

64. Gjatë vendosjes për kërkesën e Avokatit të Popullit, Gjykata mund t'i marrë parasysh si fakte notore pensionet për deputetë në disa vende të tjera, si në Austri, Çeki, Estoni, Letoni, Luksemburg, Sllovaki. Deputetët i realizojnë të drejtat e tyre për sigurim pensional në pajtim me aktin e përgjithshëm ligjor që përcakton të drejtën për sigurim pensional për të gjithë të punësuarit njësoj, pa pasur fond të veçantë për deputetët. *Shih, Akti Nr. 155/1995 Coll., për sigurimin pensional, i cili hyri në fuqi më 1 janar 1996 (Republika e Çekisë), Akti për Pensionet e Financuara, i miratuar më 14 prill 2004 (Rep. e Estonisë), Fonds et Régimes Complémentaires de Pension (Luxembourg). Akti Nr. 43/2004 Coll. për kursimet e pensionit të pleqërisë (Republika e Sllovakisë).*
65. Një praktikë tjetër është themeluar në Angli (*shih, Instrumentet statutare 2009 Nr. 1920 Pensionet – Pensionet Parlamentare (Ndryshimet) Rregulloret 2009*) dhe në Francë (Skema Pensionale e deputetëve, që ishte krijuar nga Dhoma e Deputetëve më 23 dhjetor 1904, financohet nga kontributet e siguruara nga shtesat parlamentare dhe

nga subvencionimi që përfshihet në buxhetin e Kuvendit Kombëtar (shih: http://www.assemblee-nationale.fr/english/synthetic_files/file_15.asp), sipas të cilës deputetët janë të obliguar t'i realizojnë të drejtat për pension nëpërmes fondit pensional të parlamentit, që është një lloj i veçantë i sigurimit pensional i cili financohet nga të ardhurat e deputetëve dhe plotësohet nga buxheti i parlamentit. Gjithashtu, Parlamenti Italian ka një fond të posaçëm pensional për deputetët e vet, megjithatë, deputetët janë të obliguar të japin 5.6% të pagës së tyre në këtë fond pensional (shih <http://www.legco.gov.hk/yroo-01/english/library/ein7.pdf>).

66. Ndërsa Danimarka, Qiproja, Rumania, Suedia, Finlanda dhe Mali i Zi këtë çështje e kanë rregulluar me akte të ndryshme juridike, kryesisht me ligje dhe rregullore të veçanta, siç është rasti në Republikën e Kosovës, por në mënyra të ndryshme, dhe kjo nuk vlen vetëm për deputetët por edhe për zyrtarët e lartë. P.sh., në Danimarkë moshja e pensionimit të deputetit është 67 vjet, në Qipro 60 vjet, dhe kontributi i obligueshëm prej 1.75 % të pagës së deputetit në fondin pensional, në Rumani kontributet pensionale janë të obligueshme, në Suedi skema pensionale shtetërore zbatohet edhe për deputetët, por ata mbështeten edhe nga skema pensionale e parlamentit (shih <http://www.legco.gov.hk/yroo-01/english/library/ein7.pdf>).
67. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pensionet për anëtarët e Kongresit (Kuvendit), si për të gjithë punonjësit e qeverisë federale, financohen përmes kontributeve të kombinuara të punonjësit dhe punëdhënësit. Ky pension është pension suplementar i pensionit bazë të sigurimit social që kërkohet për të gjithë qytetarët amerikanë, përfshirë anëtarët e Kongresit. Shuma e pensionit bazohet në numrin e viteve të shërbimit dhe në pagën mesatare, por nuk është retroaktiv për ata anëtarë të kongresit që kanë shërbyer para miratimit të ligjit. (Shih *Akti i Sistemit të Pensionimit të Punonjësve Federalë i vitit 1986 (P.L. 99-335)* dhe *Raporti i Shërbimit të Hulumtimeve të Kongresit për Kongresin: Përfitimet e Pensionimit për Anëtarët e Kongresit, 9 shkurt 2007.*)

Analizë e vendimeve të gjykatave të tjera kushtetuese

68. Gjykata, gjithashtu mori parasysh faktin që Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë dhe Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi i kanë shpallur jokushtetuese dispozitat e ligjeve të caktuara me privilegje të njëjta të pensioneve për deputetë. Ndërsa Kuvendi i Republikës së Kroacisë i kishte zvogëluar pensionet e deputetëve para se të vendosej për këtë çështje nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë.

A. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë

69. Më 12 prill 2006, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë e shpalli jokushtetues një ligj të Maqedonisë me të cilin u jepte deputetëve, por jo edhe zyrtarëve të tjerë publikë, një pension tjetër dhe më zemërgjerë se pensionet e përgjithshme që u jepen të gjithë qytetarëve të tjerë të Maqedonisë. Gjykata konstatoi se ky ligj kishte shkelur nenet 9 dhe 32 të Kushtetutës së Maqedonisë. Neni 9 parashikonte se të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit. Neni 32 parashikon që vendi i punës është i hapur për të gjithë në kushte të njëjta. Gjykata konkludoi se nuk kishte mundur të gjente argumente që do ta arsyetonin këtë lloj të kompensimit që sigurohet vetëm për deputetë e jo për zyrtarë të tjerë publikë që po ashtu marrin pjesë në punën e autoriteteve apo organeve të zgjedhura. Gjykata vërejti që ky ligj nuk korrespondonte me parimin që çdo i punësuar ka të drejtë në pagesën përkatëse në pajtim me kontributin e tij në punë dhe parimin e barazisë në mes të bartësve të detyrës publike.
70. Ajo gjykatë theksoi:

[...] Me dispozitat e kontestuara ligjore, ligjvënësi ka krijuar kushte dhe mënyra të ndryshme të zbatimit të pensionimit të parakohshëm të cilat në esencë nuk mund të jenë asgjë tjetër përveç fitim i të drejtave në kushte të privilegjuara dhe kanë të bëjnë vetëm me ligjvënësit, jo me të gjithë zyrtarët publikë që kanë statusin e njëjtë shoqëror apo të gjithë qytetarët pa dhënë baza të arsyeshme, me çka ligjvënësi i vë qytetarët në pozitë të pabarabartë, që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 9 të Kushtetutës.” (Shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, Nr. 191/2005-0-1 të datës 04.12.2006, § 5 pika 45).

71. Siç duket, Gjykata maqedonase konkludoi se Parlamenti i Maqedonisë e kishte për obligim, në bazë të ligjit apo Kushtetutës maqedonase, të arrinte në konkluzione të detajuara që do të arsyetonin pse deputetët kishin të drejtë në përfitime të veçanta dhe të favorshme pensionale për shkak të natyrës së punës dhe përgjegjësive të tyre në krahasim me zyrtarët e tjerë publikë apo pjesëtarët e shoqërisë maqedonase në përgjithësi.

B. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë

72. Në një rast të ngjashëm, në vitin 2003, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë ka konstatuar që një legjislacion i ngjashëm për pensione nuk e kishte shkelur Kushtetutën kroate, edhe pse legjislacioni kishte zbatim retroaktiv. Ajo Gjykatë kishte konstatuar që rregullimi i pensioneve parlamentare ndryshe nga pensionet në përgjithësi, bazohet në pozitën e veçantë ligjore të deputetëve. (Shih *Dosja Nr. U-1/949/1999.*)
73. Parashtruesit në atë rast pretendonin se ky legjislacion për pensione i shkeli parimet e barazisë, drejtësisë sociale dhe statusin e barabartë të pjesëtarëve të kategorive të njëjta shoqërore. Duke konstatuar se pretendimet ishin të pabazuara, Gjykata arsyetoi se:

“Rregullimi i pensioneve parlamentare ndryshe nga pensionet në përgjithësi, sipas Gjykatës Kushtetuese, bazohet në pozitën e veçantë ligjore të deputetëve që rezultojnë nga mënyra se si e marrin postin, nga detyrat e deputetëve dhe natyra ligjore e postit të tyre, përgjegjësi më të madhe në kryerjen e detyrave të tyre të deputetit, natyra publike e punës, kufizimi i punës, papajtueshmëria e kryerjes së punëve të tjera, lënia e profesioneve të mëhershme, e të ngjashme.”

C. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi

74. Në një rast të ngjashëm, Gjykata Kushtetuese e Malit të Zi kishte deklaruar se pensioni i veçantë suplementar për deputetë dhe zyrtarë të tjerë shtetërorë që kryejnë funksionet më të larta shtetërore, ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Malit të Zi. (Shih *Nol 33/08 të Gazetës Zyrtare të Malit të Zi, U. Nr. 86/08, 43/09, 103/09 dhe 108/09, të 24 dhjetorit 2009.*)
75. Ligji i kontestuar u jepte të drejtë zyrtarëve të caktuar shtetërorë, përfshirë deputetët, për pension prej 55% deri 85% të pagës së tyre bazë, ngjashëm me legjislacionin e kontestuar në këtë kërkesë. Duke e shpallur këtë ligj jokushtetuese, Gjykata malazeze theksoi:

“Rregullimi i të drejtës për pension është një nga të drejtat e ligjshme të qytetarëve. Në lidhje me këtë, ligjvënësi është i autorizuar ta rregullojë atë të drejtë, dhe rrjedhimisht, ta ndryshojë, plotësojë dhe shfuqizojë varësisht nga rrethanat e ndryshme, siç janë kapaciteti financiar, zbatimi i masave të politikave sociale dhe të ngjashme. Megjithatë, me rastin e rregullimit të këtyre raporteve, ligjvënësi është i obliguar t'i marrë parasysh kufizimet e përcaktuara me Kushtetutë, dhe posaçërisht

ato që burojnë nga parimet e sundimit të ligjit dhe drejtësisë sociale dhe nga ato parime me të cilat mbrohen cilësi dhe vlera të caktuara kushtetuese.”

.....

“... Gjykata Kushtetuese konstaton se pozita juridike e zyrtarëve shtetërorë në bazë të nenit 1, paragrafit 2, të Ligjit ka specifikat e veta që burojnë nga Kushtetuta, prandaj rregullimi i pensioneve të tyre në një mënyrë që dallon nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve pensionale mund të bazohet në pozitën e tyre të veçantë juridike, natyrën juridike të funksioneve politike me mandate që burojnë nga Kushtetuta, përgjegjësia e shtuar në kryerjen e këtyre funksioneve, publiciteti i punës, kufizimet e mandatit, papajtueshmëria për të kryer punë të tjera gjatë mandatit, lënia e punës apo profesionit të mëhershëm në atë kohë, etj. Pensioni i privilegjuar i zyrtarëve shtetërorë, për shkak të natyrës së detyrave dhe përgjegjësive të tyre kushtetuese, rrjedhimisht do të mund të paraqiste shprehje juridike të atyre specifikave, por ai duhet gjithmonë të jetë proporcional me rrethanat e përgjithshme sociale dhe ekonomike në vend.” (Theks i shtuar)

Përfundim

76. Me rastin e përcaktimit të së drejtës për pension suplementar për deputetët e Kuvendit të Kosovës në shumën e 50%, 60% ose 70% të pagës aktuale bazë të deputetit, varësisht nga numri i mandateve të kaluara në Kuvend, dhe me rastin e përcaktimit të moshës 55 vjeçare si kusht tjetër esencial për ta fituar të drejtën për pension suplementar, duket që Kuvendi, në mënyrë të paarsyeshme, devijoi nga rregullat e përgjithshme të fitimit të së drejtës për pension të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/20 dhe me Ligjin Nr. 03/L-084 të Kuvendit të Kosovës.
77. Nëse ky nuk është “pension suplementar”, që me sa duket edhe mund të mos jetë, ekziston një përshkrim i pamjaftueshëm se çfarë është ky legjislacion: (1) pagesë për shkurtim nga puna; (2) rritje e pagës; (3) bonos; (4) sigurim i jetës; apo (5) dhuratë. Pasi nuk i ka karakteristikat pagesës për shkurtim nga puna, rritjes së pagës, sigurim i jetës apo bonusit, atëherë ai mund të jetë dhuratë pa qëllim publik qartazi të përcaktuar të cilin Kuvendi nuk ka autoritet kushtetues për ta dhënë.
78. Në këtë kërkesë duket se pensionet që duhet t’u paguhen deputetëve të pensionuar janë qartazi joproporcionale me pensionet mesatare në vend. Rendi kushtetues bazohet në parimet e demokracisë, barazisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale. Pasi pensionet e propozuara duhet të paguhen nga buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës pa kontributin e deputetëve dhe pasi do të rezultojë në pension substancial (50 % të kompensimit për një mandat të përfunduar), duket që ky legjislacion krijon diskriminim ndaj pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë dhe të gjithë pensionistëve të tjerë në Kosovë dhe i shkel parimet e barazisë dhe të drejtësisë sociale të mbrojtura me Kushtetutë, pa shpjegim apo arsyetim të mjaftueshëm për ndonjë qëllim legjitim publik për një trajtim të tillë diskriminues.
79. Gjykata, gjithashtu duhet të vërejë se Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, duke përcaktuar pensione në shkallë prej 50%, 60%, dhe 70% të pagës aktuale bazë të deputetit, ka caktuar pensione që do të jenë 8 – 10 herë më të larta se pensionet bazë që gjithashtu paguhen nga Buxheti i Kosovës. Disproporcioni i tillë në lidhje me moshën e pensionimit, dhe shuma e pensionit në krahasim me pensionin bazë, pa kurrfarë arsytimi për qëllimet që synohen të arrihen, ngritin pyetje serioze nëse Kuvendi i ka marrë parasysh nenet 7, 3 dhe 24 të Kushtetutës së Kosovës kur e ka miratuar këtë ligj.

80. Gjatë kohës së miratimit ose pas miratimit të tij, Kuvendi i Kosovës nuk ka ofruar shpjegim të arsyeshëm lidhur me “qëllimin legjitim që e ka ndjekur” me rastin e miratimit të legjislacionit që kontestohet nga Avokati i Popullit. Pa një arsyetim të tillë, ky legjislacion e humb supozimin e përgjithshëm se është kushtetues dhe në pajtim me Kushtetutën. Në të vërtetë, nga procesverbali i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, duket se OSBE-ja kishte rekomanduar fuqishëm që ky legjislacion të mos aprovohej dhe së paku një anëtar i Kuvendit kishte sugjeruar se nuk ishte koha e duhur për ta miratuar një legjislacion të tillë. Përkundër këtyre kundërshtimeve, ky legjislacion u miratua pa ndonjë shpjegim, apo arsyetim a koment, nga ministri i Financave apo Banka Qendrore lidhur me ndikimet fiskale apo ekonomike që ka miratimi i këtij ligji.
81. Prandaj, duhet të konkludohet që neni 14, paragrafi 1.6, neni 22, neni 24, neni 25 dhe neni 27 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111, i 4 qershorit 2010, nuk janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
82. Vendimi i Gjykatës nuk e ndalon Kuvendin që të miratojë legjislacion për pensione për deputetë të Kuvendit, as që e ndalon Kuvendin që të miratojë legjislacion për kompensimin e familjeve të deputetëve të Kuvendit me shumë përkatëse, nëse deputeti vdes apo lëndohet gjersa shërben si deputet, nëse Kuvendi i ka parasysh kriteret e Kushtetutës me rastin e miratimit të legjislacionit të tillë.

PËR KËTO ARSYE, NË PËRPUTHJE ME NENIN 113.2 TË KUSHTETUTËS, NENET 20 DHE 27 TË LIGJIT DHE REGULLIN 56 (1) TË RREGULLORES SË PUNËS, GJYKATA NJËZËRI

- I. E konsideron kërkesën të pranueshme;
- II. Konkludon që neni 14, paragrafi 1.6, neni 22, neni 24, neni 25 dhe neni 27 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111, i 4 qershorit 2010, nuk janë në pajtim me nenet 3.2, 7 dhe 74 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. Konsideron që neni 14, paragrafi 1.6, neni 22, neni 24, neni 25 dhe neni 27 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111, i 4 qershorit 2010, janë të pavlefshme dhe pa fuqi ligjore;
- IV. Konsideron që dispozitat e Urdhrit të përkohshëm të Gjykatës, të 18 tetorit 2011, me të cilin pezullohet zbatimi i nenit 14, paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit Nr. 03/L-111, të 4 qershorit 2010, dhe më së voni i vazhduar më 20 tetor 2011, bëhet Urdhër i përhershëm i Gjykatës;
- V. Urdhëron që ky Aktgjykim t’u dërgohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën zyrtare;
- VI. Deklaron që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani